

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHENDRYSHIME NË LIGJIN NR. 103/2016 “PËR AKUAKULTURËN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim dhe mundëson disa rregullime në aktivitetin e akuakulturës në kuadër të një qasjeje më të afërt me fusha të rëndësishme të politikës së përbashkët të peshkimit të Bashkimit Evropian, dokumentit programatik të Unionit për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe akuakulturës.

Projektligji jep përcaktimin e saktë të organizatave të prodhuesve në fushën e akuakulturës, funksionin dhe objektivat e tyre.

Në projektligj rregullohen edhe disa aspekte të tjera në lidhje me periudhën tranzitore të përcaktuar në ligj, me qëllim që aktiviteti i akuakulturës të zhvillohet normalisht, si një sektor i cili ashtu sikurse edhe në të gjithë botën po shndërrohet në zërin parësor të peshkimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi i këtij projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Organizimi i organizatave të prodhuesve në ligjin aktual mungon ndërsa për pjesën e organizatave të peshkimit është i përfshirë në ligjin “Për peshkimin”. Shfuqizimi i rregullores nr.104/2000/KE të Këshillit sjell nevojën e reflektimit të këtyre ndryshimeve edhe në legjislacioni kombëtar. Ndryshimi bazohet në rregulloren e Këshillit nr.1379/2013/KE, datë 11 dhjetor 2013, në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe të akuakulturës.

Gjatë procesit të miratimit të ligjit nr.103/2016, “Për akuakulturën”, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë u vendos edhe një dispozitë pezulluese në lidhje lejimin e aktiviteteve të reja në akuakulturë. Kjo dispozitë shtyn proceset e lejimit të ushtrimit të aktivitetit të akuakulturës, deri në përfundim të përcaktimit të zonave në të cilat do të zhvillohet ky aktivitet.

Ky pezullim, gjatë kësaj faze tranzitore prek edhe ato subjekte të cilat kanë qenë të pajisura me të drejtën e zhvillimit të aktivitetit, por deri në momentin e miratimit të ZPA-së, u mbaron kontrata. E ardhmja e zonave në të cilën këto subjekte do të zhvillojnë aktivitetin do të vendoset pas miratimit të ZPA-së si dhe mundësia e rinovimit ose jo të tyre është e parashikuar nga neni 25, i ligjit nr.130/2016. Në këtë periudhë tranzitore subjektet janë të detyruara të ndërpresin aktivitetin, pa iu dhënë e drejta për të kërkuar rinovimin e kontratës duke shkaktuar dëme ekonomike, qoftë për biznesin, ashtu edhe për ekonominë shqiptare. Ky projektligj parashikon që deri në miratimin e ZPA-së, kontrata të vazhdojë në përputhje me dispozitat e nenit 25, të ligjit nr.103/2016, “Për akuakulturën”.

Po kështu, pezullimi i përcaktuar në ligj nuk zbatohet për strukturat ekzistuese të akuakulturës, pronë shtetërore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së, si dhe me politikën e përbashkët të peshkimit (*Common Fisheries Policy*).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj përafron pjesërisht rregulloren e Këshillit nr.1379/2013/BE, datë 11 dhjetor 2013, në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe të akuakulturës, që amendon rregulloret nr.1184/2006/(KE) dhe nr.1224/2009/KE, si dhe shfuqizon rregulloren (KE) nr.104/2000 të Këshillit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 bëhet ndryshimi i pikës 7, të nenit 3, “ Përkufizimi i termave”:

Fjalja e parë ndryshohet, si më poshtë:

Zonë e Përcaktuar për Akuakulturë (ZPA), është një sistem planifikimi hapësinor apo zonimi, i kryer në nivel rajonal ose kombëtar.

Ky ndryshim, pra presupozon që ZPA-ja kryhet edhe në nivel rajonal, bëhet me qëllim që të lehtësojë fillimin e procesit të hartimit të ZPA-së, qoftë edhe pjesërisht për rajone të caktuara, në të cilat paraqitet interes për zhvillimin e akuakulturës. Psh.: nuk ka pse të jetë i ndërvarur miratimi i një ZPA-je në rajonin verilindor të vendit për zhvillimin e troftikulturës, me miratimin e një ZPA-je për zhvillimin e kultivimit të peshkut në kosha notues në det. Nga ana tjetër, hartimi i ZPA-së në nivel rajonal, kërkon burime më të vogla financimi, duke krijuar kështu mundësinë e financimit të tyre nga projekte të ndryshme, jo domosdoshmërisht në nivel kombëtar.

Po kështu, është shtuar edhe përkufizimi në lidhje me instalimet në pronësi shtetërore të cilat janë tërësia e ndërtimeve që shërbejnë për kultivimin e organizmave ujorë, të tilla si vaskat, kanalet furnizuese dhe shkarkuese, inkubatorët, laboratorët, magazinat frigoriferike, si dhe çdo ndërtim tjetër që shërben për akuakulturë dhe që janë në pronësi ose përgjegjësi menaxhimi të një enti shtetëror. Bëhet fjalë për instalime si në liqenin e Butrintit për kultivimin e midhjes, të qendrave të prodhimit të rasateve të koranit në Lin – Pogradec, dhe Zvezdë – Korçë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe për qendrën e prodhimit të rasateve në Tapizë – Krujë, në përgjegjësi administrimi të Universitetit Bujqësor Kamzë.

Në nenin 2 është bërë një ndryshim i pikës 1, të nenit 5, sipas së cilës, ZPA-ja përfshin zona të veçanta, të caktuara, përfshirë edhe instalimet në pronësi shtetërore, me qëllim aktivitetin e akuakulturës, së bashku me infrastrukturën në shërbim të saj.

Neni 3 parashikon dy shtesa (44/1 dhe 44/2) pas nenit 44 të ligjit në fuqi dhe që kanë të bëjnë me organizatat e prodhuesve të akuakulturës dhe objektivat e tyre. Organizimi i organizatave të prodhuesve në ligjin aktual mungon. Për pjesën e organizatave të peshkimit kemi parashikimin përkatës në ligjin “Për peshkimin”, ndërsa në legjislacionin për akuakulturën nuk ka parashikime mbi organizatat e prodhuesve të akuakulturës. Ndryshimi bazohet në rregulloren e Këshillit nr.1379/2013/BE, datë 11 dhjetor 2013, në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe akuakulturës.

Objektivat e organizatave të prodhuesve të akuakulturës janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit dhe synojnë realizimin e aktiviteteve të qëndrueshme të akuakulturës, sigurojnë që ushqimet për akuakulturën, me

origjinë nga peshkimi, të vijnë nga peshkimi i menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme, përmirësojnë kushtet për vendosjen në treg të produkteve të akuakulturës, përmirësojnë performancën ekonomike të subjekteve të akuakulturës dhe qëndrueshmërinë e tregjeve, promovojnë standarde të larta të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, si dhe promovojnë punësimin në zonat bregdetare dhe rurale.

Neni 4 parashikon dy shtesa (pika 4 dhe 5) në nenin 50, të ligjit nr.103/2016. Ndryshimet e propozuara në këtë nen përjashtojnë nga pezullimi i përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, strukturat ekzistuese të akuakulturës, pronë shtetërore, deri në miratimin e ZPA-së.

Gjithashtu është parashikuar se kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA-së, konsiderohen të vlefshme deri në miratimin e ZPA-së. Zgjatja e këtyre kontratave do të bëhet me kërkesë të ushtruesit të veprimtarisë së akuakulturës, në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse, të përcaktuara në pikën 2, të nenit 25, të ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucioni që ngarkohet për zbatimin e këtij projektligji është Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është përgatitur nga grupi i punës i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ngritur me urdhrin e ministrit nr.138 datë 30.3.2018.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE